



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

PSE INSTITUCIONET E KOSOVËS DUHET URGJENTISHT TË FORCOJNË SIGURINË DHE REZILIENCËN E UJËRAVE TË SAJ?

NDËRTIMI I REZILIENCËS SË INFRASTRUKTURËS KRITIKE



Autor: Jon Limaj, Mentor Vrajolli

RRETH PROGRAMIT KËRCËNIMET E REJA

Kërcënimet e Reja (The Emerging Threats Programme) është projektuar si një përgjigje ndaj kërcënimeve të rritje të sigurisë vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Qëllimi i tij kryesor është të konsolidojë dhe të ofrojë një kuptim më të mirë të kërcënimeve në zhvillim që vazhdimisht largohen nga konceptualizimi tradicional i sfidave të sigurisë. Duke pasur parasysh shtrirjen e kërcënimeve në zhvillim që lidhen me sigurinë kibernetike dhe dezinformimin, ky program synon të ndërtojë kapacitetet e brendshme organizative për të ofruar ekspertizë të bazuar në dëshmi për të funksionalizuar përgjigjet institucionale ndaj këtyre sfidave. Hulmimi i bazuar në dëshmi në lidhje me Programin e Kërcënimeve e Reja (The Emerging Threats Programme) fokusohet në: infrastrukturën kritike, sigurinë kibernetike, dezinformimin dhe sfidat hibride të sigurisë. Përderisa vlerësimi (et) e nevojave, monitorimi dhe hulmimi mbeten veprimet më të rëndësishme për t'u zhvilluar në program, QKSS synon të shfrytëzojë ekspertizën e krijuar për të rritur drejtpërdrejt kapacitetet e institucioneve dhe agjencive ekzekutive për t'u përgjigjur në mënyrë efektive sfidave të sigurisë kibernetike dhe dezinformimit. Programi do të zhvillohet përmes:

- Hulmimet më të reja të bazuara në dëshmi në lidhje me kërcënimet në zhvillim si: siguria kibernetike dhe dezinformimi;
- Fushatat për ngritjen e vetëdijes dhe avokim të synuar për të përmirësuar nivelin e të kuptuarit të sfidave që lidhen me sigurinë kibernetike dhe dezinformimin në Kosovë;
- Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për institucionet dhe agjencitë ekzekutive për të zhvilluar mjete dhe strategji për të hartuar përgjigje ndaj kërcënimeve në zhvillim.

Për më shumë informacion, na kontaktoni në:

EmergingThreats@qkss.org

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën Angleze.

Ky dokument i shkurtër i politikave u publikua në kuadër të projektit SMART Balkans, i zbatuar në bashkëpunim nga Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Qendra për Hulmimet dhe Hartim Politikash (CRPM), me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë.

PSE INSTITUCIONET E KOSOVËS DUHET URGJENTISHT TË FORCOJNË SIGURINË DHE REZILIENCËN E UJËRAVE TË SAJ?

NDËRTIMI I REZILIENCËS SË INFRASTRUKTURËS KRITIKE

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
1. GJENDJA AKTUALE E BURIMEVE UJORE NË KOSOVË	3
2. RREGULLIMI LIGJOR I INFRASTRUKTURËS KRITIKE TË UJIT	4
3. KORNIZA STRATEGJIKE PËR MBROJTJEN E INFRASTRUKTURËS KRITIKE TË UJIT	5
4. CENUESHMËRITË E PËRGJITHSHME TË INFRASTRUKTURËS KRITIKE NË SEKTORIN E UJIT	6
5. KËRCËNIMET E QËLLIMSHME NDAJ INFRASTRUKTURËS KRITIKE TË UJI	7
REKOMANDIME	9
REFERENCAT	10

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitet e fundit, kërcënimet ndaj infrastrukturës kritike janë shtuar ndjeshëm. Kjo kryesisht si pasojë e kërcënimeve globale në rritje dhe dixhitalizimit të proceseve operacionale kyçe, përfshirë ato në sektorin e ujërave. Si rezultat, Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me palët relevante, ka vënë theks të madh në sigurimin e reziliencës në këtë sektor.

Ndërsa Kosova ka një kuadër ligjor për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, duke përfshirë Ligjin për Ujërat dhe Ligjin për Infrastrukturën Kritike, ekzistojnë mangësi në zbatimin e tyre. Për më tepër, mungon një përafrim i plotë me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat. Për një menaxhim efektiv të ujërave, nevojiten integritet të plota dhe ndryshime legjislative.

Lidhur me Ligjin për Infrastrukturën Kritike, sfidat kryesore në zbatimin e tij aktualisht burojnë nga vonesat e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës (MPB) në krijimin e mekanizmave përgjegjës zbatues. Paralelisht me fazën fillestare të krijimit të këtyre mekanizmave, ka pasur nevojë për amendimin e legjislacionit ekzistues për ta përafruar atë me legjislacionin më të fundit të BE-së. Sipas raporteve, draft-ligji aktual që është shpërndarë nuk e përcakton qartë sektorin e infrastrukturës kritike. Sektori i ujërave nuk rregullohet vetëm nga Ligji për Infrastrukturën Kritike. Përkundrazi, ai është gjithashtu subjekt i Ligjit për Ujërat e Kosovës, i cili përmban detaje mbi mënyrën se si burimet ujore menaxhohen, mbrohen dhe përdoren. Ky ligj përcakton detyrat e institucioneve të ndryshme, si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore. Por, ashtu si me Ligjin për Infrastrukturën Kritike, edhe Ligji për Ujërat nuk arrin të përputhet plotësisht me rregullat e BE-së, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e integruar të ujërave dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në përgjithësi, infrastruktura ujore e Kosovës përfshin sistemet e furnizimit me ujë, objektet e trajtimit, rrjetet e shpërndarjes dhe strukturat për menaxhimin e përmbytjeve. Për shkak të karakteristikave gjeografike, Kosova është shumë e ndjeshme ndaj mungesës së burimeve ujore. Pavarësisht disa përpjekjeve për modernizim, pjesa më e madhe e infrastrukturës mbetet e vjetruar, dhe vendi përballlet me sfida të

mëdha nga urbanizimi, kërkesat bujqësore dhe ndryshimet klimatike. Investimet e fundit në këtë sektor janë përqendruar kryesisht në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese të ujit. Megjithatë, gjatë dekadave të fundit nuk janë bërë investime strategjike të rëndësishme për të rritur reziliencën e ujërave. Menaxhimi i infrastrukturës ujore është i fragmentuar dhe i mungojnë mekanizmat e duhura të koordinimit, gjë që pengon zbatimin e veprimeve efektive dhe të koordinuara për adresimin e sfidave të sektorit.

Ndryshimet klimatike duket se kanë ndikuar ndjeshëm në motin e vendit, të manifestuara me sezone të zgjatura të thata, të ndjekura nga reshje të mëdha dhe të shpejta që shkaktojnë përmbytje të rënda dhe ekspozojnë kapacitetet e kufizuara të sistemeve të kanalizimit të ujërave. Ndotja e ujit mbetet gjithashtu një problem i vazhdueshëm, ndërsa cilësia e ujit vazhdon të jetë një sfidë madhore për këtë sektor.

Kërcënimi nga veprimet e qëllimshme që synojnë infrastrukturën kritike në Kosovë, përfshirë sabotazhet apo aktivitete të tjera keqdashëse, është në rritje. Megjithatë, incidente si sulmi ndaj Ibër Lepenc mund të mos klasifikohen si akte të terrorizmit ndërkombëtar, por më tepër si veprime të lokalizuara ose të motivuara politikisht. Sulmi i fundit me eksploziv ndaj Kanalit të Ujit Ibër-Lepenc në nëntor 2024, i ngjashëm me incidentin e Banjskës në shtator 2023, ka ngritur pyetje për përfshirjen e mundshme të Serbisë. Këto akuza u theksuan nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, e cila deklaroi se provat tregojnë ndikime ndërkufitare. Ambasada Amerikane në Kosovë dënoi publikisht këto sulme,

duke nënvizuar seriozitetin e kërcënimeve ndaj infrastrukturës kritike.¹ Veçanërisht, grupi përgjegjës për sulmin në Banjskë dihet se operon brenda territorit të Serbisë, ku terroristi i njohur Milan Radoičiq lëviz lirish në Beograd dhe ruan lidhje të forta me Presidentin serb Vuçiq si dhe me partinë politike në pushtet, SNS. Në këtë kontekst, përfshirja e mundshme

1. <https://telegrafi.com/en/The-United-States-condemns-the-attack-on-the-Iber-Lepenci-canal%2C-we-have-offered-our-full-support-to-identify-the-criminals/>

e Serbisë mund të përfshijë qoftë mbështetje direkte apo lehtësim të veprimeve që synojnë infrastrukturën e Kosovës nga entitete që operojnë brenda kufijve të saj. Kjo situatë ngre shqetësime për shfaqjen e terrorizmit të sponsorizuar nga shteti, që mund të ndikojë jo vetëm Kosovën, por edhe gjithë Ballkanin Perëndimor. Sjellja e tillë e vazhdueshme mund të përbëjë rreziqe të mëdha jo vetëm për infrastrukturën jetike, por edhe për paqen rajonale. Ndikimi i Rusisë në rajon nxit destabilitet, duke përdorur dezinformimin dhe presionin për të thelluar tensionet lokale. Kjo mund të përshkallëzohet nga destabilizimi në mbështetje të grupeve ekstremiste, me qëllim bllokimin e integritit të rajonit me Perëndimin. Në të njëjtën kohë, infrastruktura kritike mbetet e cenueshme ndaj sulmeve terroriste, përfshirë ato me motive fetare, të cilat rëndohen edhe më shumë nga mungesa e një strategjie të qartë për mbrojtjen e saj.

Infrastruktura kritike në Kosovë kërkon ndërhyrje të menjëhershme si më poshtë:

- > Përditësimi urgjent dhe zbatimi i Ligjit të ri për Infrastrukturën Kritike;
- > Përshtatja dhe përmirësimi i strategjive kombëtare dhe protokolleve të sigurisë në lidhje me infrastrukturën kritike;
- > Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit për ujërat me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat;
- > Modernizimi dhe mirëmbajtja koherente e infrastrukturës së vjetruar dhe zgjerimi i trajtimit të ujërave të zeza;
- > Nxitja e partneriteteve publike-private dhe përmirësimi i kontrollit të cilësisë së ujit;
- > Forcimi i kuadrit institucional dhe përmirësimi i reziliencës ndaj ndryshimeve klimatike në menaxhimin e ujërave;
- > Sigurimi i mbrojtjes fizike të infrastrukturës, veçanërisht në pjesët që konsiderohen thelbësore;
- > Përpjekje të koordinuara, rritje të investimeve dhe bashkëpunim ndërkombëtar janë thelbësore për të siguruar një infrastrukturë ujore të qëndrueshme dhe rezistente, duke mbështetur aspiratat e Kosovës për anëtarësim në BE dhe duke përmirësuar jetesën e popullatës dhe mjedisin.

1. GJENDJA AKTUALE E BURIMEVE UJORE NË KOSOVË

E vendosur në rajonin qendror të Gadishullit Ballkanik, me një lartësi mesatare mbi 600 metra mbi nivelin e detit, Kosova është ndjeshëm e prekur nga mungesa e burimeve ujore. Burimet kryesore të ujit janë akullnajat që shkrihen nga malet e Sharrit dhe Rugovës, të cilat furnizojnë katër pellgje lumore të përbashkëta me vendet fqinje. Edhe pse gjatë dy dekadave të fundit ka pasur disa përpjekje për modernizimin e infrastrukturës ujore, urbanizimi i shpejtë, kërkesat bujqësore dhe ngrohja globale vazhdojnë të paraqesin sfida në rritje për burimet ujore të Kosovës. Tendencat e fundit të dixhitalizimit të shpejtë të sektorit të infrastrukturës kritike të ujit, të nxitura nga kërcënimet në rritje nga terrorizmi, përfshirë atë të sponsorizuar nga shteti, theksojnë nevojën për investime të mëdha dhe masa sigurie në këtë sektor.

E vendosur në rajonin qendror të Gadishullit Ballkanik, me një lartësi mesatare mbi 600 metra mbi nivelin e detit, Kosova përballlet ndjeshëm me mungesën e burimeve ujore. Burimet kryesore të ujit vijnë nga shkrrirja e akullnajave të maleve të Sharrit dhe Rugovës, të cilat furnizojnë katër pellgje lumore të përbashkëta me vendet fqinje. Pavarësisht disa përmirësimeve në modernizimin e infrastrukturës ujore gjatë dy dekadave të fundit, urbanizimi i shpejtë, kërkesat bujqësore dhe ngrohja globale vazhdojnë të paraqesin sfida të mëdha për burimet ujore të Kosovës. Tendencat e fundit të dixhitalizimit të shpejtë të sektorit të infrastrukturës kritike të ujit, të nxitura nga kërcënimet në rritje të terrorizmit, përfshirë ato të sponsorizuara nga shteti, theksojnë nevojën për investime të mëdha dhe masa të rrepta sigurie në këtë sektor.

Infrastruktura ujore në Kosovë përbëhet nga katër shtylla kryesore: sistemet e furnizimit me ujë, objektet e trajtimit të ujërave, rrjetet e shpërndarjes dhe infrastruktura për menaxhimin e përmbytjeve. Sistemet e furnizimit me ujë përbëhen nga burime ujore sipërfaqësore, përfshirë lumenjtë kryesorë si Drini

i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci; si dhe burime ujore nëntokësore, nga akuiferët dhe pusët, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në zonat rurale. Akuiferët kryesorë përfshijnë ato në rajonet e Dukagjinit dhe Fushës së Kosovës. Gjithashtu, sistemi i furnizimit me ujë mbështetet në liqenet dhe rezervuarët artificialë si Batllava, Ujmani, Badovci, Radoniqi etj., të cilët janë thelbësorë për furnizimin me ujë dhe ujitjen. Lumenjtë dhe liqenet e shumta ofrojnë mbështetje të rëndësishme për bujqësinë, industrinë dhe përdorimin shtëpiak.

Objektet e Trajtimit të Ujit përfshijnë Impiantet e Trajtimit të Ujit të Pijshëm që sigurojnë furnizimin e popullsisë urbane me ujë të pastër: impiante si ato në Batllavë dhe Badovc trajtojnë ujin për konsum të sigurt. Trajtimi i ujërave të zeza në Kosovë është i kufizuar, me vetëm disa impiante funksionale. Si rezultat, shumë qendra urbane derdhin ujërat e zeza të patrajtuara ose të trajtuara pjesërisht në lumenj, duke shkaktuar ndotje dhe shqetësime për shëndetin publik.

Rrjetet e Shpërndarjes përbëhen nga një rrjet i gjerë tubacionesh dhe stacione pompimi: këto tubacione dhe stacione pompimi shpërndajnë ujin e trajtuar në shtëpi, biznese dhe industri. Zonat urbane kanë sisteme relativisht të zhvilluara, ndërsa rajonet rurale shpesh përballen me sfida në aksesin dhe cilësinë e ujit.

Infrastruktura për Menaxhimin e Përmbytjeve përfshin argjinatura dhe diga si infrastrukturë për parandalimin e përmbytjeve, veçanërisht në zonat pranë lumenjve kryesorë, që janë jetike. Megjithatë, një pjesë e madhe e kësaj infrastrukture ka nevojë për përmirësime dhe mirëmbajtje.

Gjithashtu, sistemet efektive të kanalizimit janë thelbësore për menaxhimin e ujërave të tepërta gjatë reshjeve të dendura, veçanërisht në zonat urbane që janë të prirura ndaj përmbytjeve.

2. RREGULLIMI LIGJOR I INFRASTRUKTURËS KRITIKE TË UJIT

Sektori i ujit në Kosovë rregullohet nga Ligji për Ujërat e Kosovës (Nr. 04/L-147).² Ky ligj rregullon të gjitha burimet dhe administrimin e ujit, përdorimin e ujit, mbrojtjen e tij dhe mbrojtjen nga rreziqet e lidhura me ujin. Ai përcakton autoritetet për menaxhimin e ujërave, matjen dhe hartimin e rrezikut nga përmbytjet, krijimin e politikave për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, si dhe ndërtimin dhe mirëmbajtjen e mbrojtjeve kundër përmbytjeve. Ndryshimet gjithashtu përfshijnë koordinimin qendror dhe lokal si dhe pjesëmarrjen publike në vendimet për menaxhimin e përmbytjeve. Ligji për Ujërat e Kosovës është i përafuar me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat (Direktiva e BE-së 2000/60/EC), duke miratuar një qasje të integruar për menaxhimin e ujërave. Ngjashmëritë përfshijnë kërkesën për Plane të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore (RBMPs) për përdorim të qëndrueshëm të ujërave. Transpozimi i plotë është i realizueshëm në fusha si Menaxhimi i Cilësisë së Ujit, Kontrolli i Ndotjes dhe Instrumentet Ekonomike. Megjithatë, ligji përmban boshllëqe dhe mospërputhje, të tilla si përkufizime të paqarta, kundërshtime në koncepte kyçe dhe zbatim të pjesshëm të Direktivës së BE-së.

Kosova ka miratuar Ligjin për Infrastrukturën Kritike (2018), i cili ka hyrë në fuqi nga prilli i vitit 2019 dhe ofron një kuadër të plotë ligjor për mbrojtjen e infrastrukturave kritike, përfshirë sektorin e ujërave³. Ky ligj fillimisht ishte në përputhje me rregulloret e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për të trajtuar rreziqet që lidhen me fatkeqësitë natyrore, aktet terroriste dhe rreziqe të tjera që mund të kërcënojnë infrastrukturën kritike. Megjithatë, problemi me të ishte mungesa e zbatimit, për shkak të dështimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të krijuar mekanizmat e parashikuar. Në vitin 2022, BE-ja

2. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659&langid=2>

3. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16313>

miratoi Direktivën e re (NIC 2), e cila solli ndryshime të rëndësishme rregullatore. Si rezultat, rishikimi i këtij ligji është përfshirë në agjendën legjislative të vitit 2024. Një draft i këtij ligji tashmë është dërguar në kuvend. Mangësitë kryesore të ligjit të mëparshëm, si mungesa e një përkufizimi të saktë të infrastrukturës kritike, janë të pranishme edhe në draftin e ri. Ligji duhet të ofrojë udhëzime më të qarta për përkufizimin e infrastrukturës kritike të ujit, pavarësisht nga identifikueshmëria relative e saj krahasuar me sektorët e tjerë. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh rritjen e cenueshmërisë së infrastrukturës kritike, përfshirë sektorin e ujit, është thelbësore që ligji të ndryshohet paralelisht me konsolidimin e mekanizmave përgjegjës për zbatimin e tij.

Pjesë e legjislacionit që trajton aspektet e sigurisë dhe mbrojtjes së infrastrukturës kritike, përfshirë sektorin e ujit, është gjithashtu Ligji Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe të tjera.⁴ Ky ligj rregullon mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera.

Një tjetër pjesë e rëndësishme e legjislacionit që mbulon sektorin e ujit është Ligji Nr. 06/L-035 për Aktivitetet Hidrometeorologjike. Ky ligj përcakton mënyrën e kryerjes së aktiviteteve meteorologjike, sistemet e paralajmërimit të hershëm, ekspertizat, produktet dhe shërbimet e ofruara nga këto aktivitete, për të mbështetur informimin e institucioneve lokale dhe qendrore, publikut, si dhe institucioneve ndërkombëtare dhe rajonale. Nga ana tjetër, Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit synon të harmonizojë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale me parimet bazë për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

4. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2775>

3. KORNIZA STRATEGJIKE PËR MBROJTJEN E INFRASTRUKTURËS KRITIKE TË UJIT

Përveç miratimit të legjislationit, ekzistojnë strategji dhe plane veprimi të rëndësishme për të siguruar menaxhimin dhe mbrojtjen efektive të burimeve ujore. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2016 - 2020⁵ është një nga dokumentet më të rëndësishme të këtij lloji, megjithatë duket se nuk është rinovuar që nga skadimi i tij në vitin 2020. Ky ligj supozohet të projektojë zhvillim të qëndrueshëm, të integrojë reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në planet dhe politikatat e zhvillimit, si dhe të ndërtojë kapacitetin e komunitetit për t'u përballur me fatkeqësitë. Nga ana tjetër, duket se institucionet e Kosovës kanë miratuar së fundmi një Strategji Shtetërore të Ujërave 2023-2027 dhe Plan Veprimi 2023-2025.⁶ është një nga dokumentet më të rëndësishme të këtij lloji, megjithatë duket se nuk është rinovuar që nga skadimi i tij në vitin 2020. Ky ligj supozohet të projektojë zhvillim të qëndrueshëm, të integrojë reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në planet dhe politikatat e zhvillimit, si dhe të ndërtojë kapacitetin e komunitetit për t'u përballur me fatkeqësitë. Nga ana tjetër, duket se institucionet e Kosovës kanë miratuar së fundmi një Strategji Shtetërore të Ujërave 2023-2027 dhe Plan Veprimi 2019- 2021⁷ e cila synon të ofrojë një kuadër të plotë të politikave për zbutjen e ndryshimeve

klimatike, bazuar në nivelin aktual të informacionit. Një komponent i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike është thelbësor për t'u përgjigjur dhe për të parashikuar ndikimet e ndryshimeve klimatike në Kosovë. Këto ndikime aktuale dhe të pritshme përfshijnë ekspozimin ndaj rreziqeve si thatësitrat, përmytjet dhe zjarret pyjore, të cilat do të intensifikohen me ndryshimet klimatike. Megjithatë, një fushë ku sektori i infrastrukturës kritike të ujit nuk duket se ka dhënë një fokus të veçantë është brenda kuadrit të strategjive të sigurisë dhe sundimit të ligjit. Strategjitë e lidhura me sigurinë dhe sundimin e ligjit, si Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022-2027, janë shembuj të tillë⁸, strategjia e Mbrojtjes së Kosovës dhe Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028 nuk duket se i japin përparësi kërcënimeve ndaj infrastrukturës kritike të shkaktuara nga sulmet terroriste, përfshirë ato të sponsorizuara nga aktorë shtetërorë të huaj.

Duke pasur parasysh rreziqet e shtuara globale të sigurisë pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia në vitin 2022, kërcënimet e mundshme janë rritur ndjeshëm. Për këtë arsye, rishikimi i strategjive me fokus në mbrojtjen e infrastrukturës kritike është i domosdoshëm.

5. <https://faolex.fao.org/docs/pdf/kos170267.pdf>

6. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=78647>

7. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=29356>

8. <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/2-Strategjia-e-Sigurise-e-Kosoves-ENG.pdf>

4. CENUESHMËRITË E PËRGJITHSHME TË INFRASTRUKTURËS KRITIKE NË SEKTORIN E UJIT

Kosova përballet me disa probleme në sistemin e saj të ujit. Infrastruktura e vjetruar, sisteme të vjetruara të shpërndarjes dhe furnizimit me ujë, rrjedhje të rregullta, humbje dhe ndërprerje. Infrastrukturat e degraduara rrezikojnë stabilitetin e furnizimit me ujë dhe ndërpresin aktivitetet në shtëpi, punë dhe bujqësi. Modernizimi i gabuar dhe mungesa e mirëmbajtjes së duhur pengojnë sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm me ujë.

Në përgjithësi, investimet në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës ujore mbeten relativisht të ulëta. Kompanitë shtetërore të ujit mbështeten shumë në financimet dhe huatë e huaja për të përballuar krizën e vazhdueshme të ujit. Megjithatë, këto fonde të jashtme janë të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesën në rritje. Pengesa kryesore për arritjen e qëndrueshmërisë në sektorin e ujit është mungesa e financimit dhe investimeve të mjaftueshme lokale. Kjo mungesë financimi dhe investimi në nivel lokal përbën sfidën më të madhe për qëndrueshmërinë e këtij sektori.

Kosova duhet të diversifikojë prodhimin e ujit, veçanërisht në rajonin e Rrafshit të Kosovës, duke pasur parasysh mungesën e rezervuarëve të qëndrueshëm për ujë të pijshëm. Është thelbësore që institucionet të avancojnë me ndërtimin e liqenit artificial në Firajë, në komunën e Shtërpçës, i cili pritet të sigurojë furnizim me ujë për rajonin më të gjerë të Ferizajt dhe Gjilanit. Ky liqen pritet të përfitojë nga rrjedha e lumit Lepenc dhe pritet të ketë vetëm një ndikim të kufizuar në rrjedhën ndërkuftare të lumenjve (Kosovë dhe Maqedoni e Veriut).

Cilësia e ujit në Kosovë kërcënohet nga ndotja

industriale, rrjedhjet bujqësore dhe ujërat e zeza të papërpunuara. Qytetet e mëdha derdhen ujërat e zeza të patrajtuara ose të trajtuara pjesërisht në lumenj, duke dëmtuar shëndetin e njerëzve dhe mjedisin. Ndotja e ujit ndikon negativisht në biodiversitet dhe shërbimet e ekosistemit. Megjithatë, investimet dhe masat për të reduktuar ndotjen e ujit mbeten ende shumë të kufizuara. Ngjarjet ekstreme të motit si pasojë e ndryshimeve klimatike ndikojnë gjithashtu në disponueshmërinë dhe shpërndarjen e ujit. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe rritja e reziliencës së infrastrukturës ujore janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm. Për më tepër, qeverisja e burimeve ujore është relativisht e paorganizuar, me përfshirjen e disa institucioneve të ndryshme që janë të vështira për t'u koordinuar. Forcimi i këtij sistemi dhe përmirësimi i mjedisit të zbatimit janë thelbësore për të mbështetur përpjekjet për ruajtjen e ujit.

Së fundmi, duhet theksuar se mungon mbledhja dhe monitorimi i duhur i të dhënave për të matur cilësinë e ujit dhe për të përdorur në mënyrë efektive Planet e Menaxhimit të Pellgjeve Lumore. Cilësia e ujit shpesh matet dhe monitorohet në mënyrë të pamjaftueshme. Gjithashtu, angazhimi i rregullt i publikut dhe i palëve të interesuara—i domosdoshëm për sigurimin e pjesëmarrjes aktive në menaxhimin e ujit—shpesh anashkalohet. Për më tepër, sfida e sigurimit të financimeve të duhura dhe realizimit të investimeve adekuate në infrastrukturën dhe menaxhimin e ujit mbetet ende e paqartë. Zhvillimi i planeve të qarta të financimit dhe tërheqja e investitorëve të huaj janë hapa thelbësorë për të adresuar këto çështje.

5. KËRCËNIMET E QËLLIMSHME NDAJ INFRASTRUKTURËS KRITIKE TË UJIT

Sektori i infrastrukturës kritike të ujit në Kosovë duket se është i cenueshëm jo vetëm ndaj kërcënimeve mjedisore dhe industriale, por edhe ndaj kërcënimeve të qëllimshme terroriste dhe akteve të agresionit. Disa faktorë kontribuojnë në këtë cenueshmëri. Së pari, terrorizmi (qoftë i motivuar fetarisht apo politikisht) për dekada ka qenë një çështje globale. Kosova, e cila vazhdimisht është rreshtuar krah aleatëve perëndimorë, veçanërisht në koalicionet kundër ekstremizmit të bazuar në fenë, duhet të mbetet vigjilente ndaj kërcënimeve që vijnë nga ky fenomen, veçanërisht ndaj infrastrukturës kritike. Pavarësisht rënies së fuqisë së ekstremizmit të bazuar në fenë gjatë viteve të fundit, neglizhenca ndaj këtij rreziku mund të rezultojë fatale.

Së dyti, Kosova mbetet në një situatë konfliktuale me fqinjën e saj veriore, Serbinë, e cila paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë si për integritetin territorial, ashtu edhe për sektorin e infrastrukturës kritike. Për dekada me radhë, veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës, kanë operuar struktura paralele të mbështetura nga institucionet shtetërore serbe, që synojnë të pengojnë integrimin e komunitetit serb të Kosovës dhe të sabotojnë funksionimin e duhur të institucioneve të Kosovës. Prej vitesh ka pasur shqetësime për kërcënimet e orkestruara nga autoritetet serbe ndaj infrastrukturës kritike të Kosovës. Ndër këto shqetësime, në mënyrë të veçantë përfshihen Liqeni Artificial i Ujmanit (Liqeni i Gazivodës) dhe infrastruktura e tij ujore e lidhur, që është jetike për një pjesë të madhe të Kosovës në furnizimin me ujë për familjet, bizneset, bujqësinë dhe infrastrukturën kritike si Korporata Energjetike e Kosovës, e cila është përgjegjëse për rreth 95 për qind të energjisë elektrike të prodhuar brenda vendit.

Sulmi terrorist me bombë ndaj sistemit të Kanalit

Ibër-Lepenc më 29 nëntor 2024 ka konfirmuar frikën ekzistuese. Ndërsa hetimet janë ende në vazhdim dhe disa të dyshuar janë arrestuar, ky sulm lidhet me Sulmin Terrorist të Banjskës nga shtatori 2023. Sulmi i vitit 2023 përfshinte individë të lidhur me institucione qeveritare dhe të sigurisë të nivelit të lartë në Serbi, asnjë prej të cilëve nuk është arrestuar, pavarësisht seriozitetit të incidentit. Veçanërisht, figura kyçe të përfshira drejtpërdrejt në atë ngjarje janë parë në shoqëri me zyrtarë të lartë të qeverisë në Serbi, duke sugjeruar se shteti serb mund të jetë hapur mbështetës i veprimeve armiqësore ndaj institucioneve shtetërore të Kosovës, përfshirë infrastrukturën kritike.⁹

Duke pasur parasysh se Liqeni Artificial i Ujmanit, rezervuari më i rëndësishëm i ujit në Kosovë, ndodhet në Komunën e Zubin Potokut, e cila është në kufi me Serbinë dhe një nga katër komunat veriore përgjatë lumit Ibër, ku Serbia ka pasur një përfshirje të gjerë me struktura paralele, ai mbetet një pikë e rëndësishme e cenueshmërisë. Sistemi i Furnizimit me Ujë Ibër-Lepenc, i cili shpërndan ujë nga Rezervuari i Ujmanit, është gjithashtu në rrezik. Prandaj, sulmi i fundit thekson cenueshmërinë e rezervuarit të Liqenit Artificial të Ujmanit dhe sistemit të kanalit të ujit Ibër-Lepenc ndaj kërcënimeve nga grupet terroriste, potencialisht të mbështetura nga Serbia.

Shpërthimi në Kanalin e Ujit Ibër-Lepenc kërcënoi furnizimin me ujë për disa komuna të Kosovës dhe Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Pavarësisht ashpërsisë së këtij sulmi terrorist, institucionet e Kosovës menaxhuan me shpejtësi dëmet, duke shmangur pasoja të mëdha afatgjata dhe duke treguar gatishmëri ndaj sulmeve ndaj infrastrukturës kritike. Autoritetet rikthyen furnizimin me ujë të KEK-ut me shpejtësi, duke parandaluar një krizë energjetike,

⁹ <https://www.kosovopolice.com/en/critical-infrastructure-of-the-iber-lepenci-water-canal-attacked/>

megjithëse komunat e prekura përjetuan ndërprerje të furnizimit me ujë për javë të tëra. Në diskutimet e fundit përfshihet ndërtimi i një liqeni artificial pranë KEK-ut për të mbrojtur këtë infrastrukturë jetike nga kërcënimet e ardhshme, megjithëse projekte të tilla kërkojnë kohë të konsiderueshme për t'u realizuar. Si rezultat, këto asete kritike të infrastrukturës ujore do të vazhdojnë të jenë të cenueshme ndaj sulmeve terroriste shpërqendruese të sponsorizuara nga shteti kundërshtar. Në këtë kontekst, terrorizmi i sponsorizuar nga shteti përfshin akte terroriste të mbështetura nga shtete të tjera, me qëllim destabilizimin e shteteve të tjera ose arritjen e objektivave politike, shpesh duke synuar infrastrukturën kritike.

Edhe pse Serbia nuk është përmbajtur nga theksimi i lidhjeve të saj me grupe terroriste si grupi i Banjskës apo nga organizimi i strukturave paralele që synojnë sabotimin e institucioneve shtetërore të Kosovës, ajo nuk është i vetmi kërcënim i jashtëm ndaj infrastrukturës kritike të Kosovës. Shumë nga këto struktura paralele dhe terroriste që operojnë në veri kanë krijuar lidhje të kahershme me shërbimet sekrete ruse, të cilat kanë interes për destabilizimin e sigurisë së Kosovës. Si pasojë, megjithëse nuk ka prova të drejtpërdrejta për përfshirjen e Rusisë në këtë sulm specifik, mundësia e aktiviteteve terroriste të frymëzuara nga Rusia, të kryera nga këto grupe, nuk mund të përjashtohet. Shumë nga këto grupe ruajnë lidhje me shërbimet sekrete ruse, të cilat kanë interes të drejtpërdrejtë për të destabilizuar sigurinë e Kosovës. Ky ndikim shpesh manifestohet në mënyrë të tërthortë përmes mbështetjes, financimit ose udhëzimeve strategjike, që potencialisht mund të

lehtësohen përmes institucioneve shtetërore serbe. Kërcënime të tilla mund të shtrihen edhe në sektorë të tjerë të infrastrukturës kritike përtej burimeve ujore.

Kjo situatë nënvizon nevojën urgjente për mbrojtje të fuqishme të infrastrukturës kritike. Politikat për mbrojtjen e këtyre asetëve thelbësore duhet të jenë dinamike dhe të përshtatshme ndaj natyrës në evolucion të kërcënimeve. Ndërsa dëmet nga sulmi ndaj sistemit të ujit Ibër-Lepenc u minimizuan falë një reagimi të shpejtë nga forcat e rendit dhe shkallës së menaxhueshme të dëmit, sulmet e ardhshme mund të jenë shumë më të rënda, duke e bërë të pamundur një reagim efektiv të tillë. Prandaj, është jetike që të forcohen masat parandaluese për sektorin e infrastrukturës kritike.

Së fundmi, është e rëndësishme të theksohet se shqetësimet lidhur me cenueshmërinë e infrastrukturës kritike ujore në Kosovë janë shprehur jo vetëm nga popullata dhe institucionet shqiptare të Kosovës, por edhe nga qytetarët serbë të Kosovës në zona si Zubin Potoku dhe Graçanica. Këto shqetësime lidhen me frikën e sulmeve të qëllimshme ndaj digave në liqenet e Ujmanit dhe Badovcit, pranë të cilave jeton një numër i konsiderueshëm i popullatës serbe të Kosovës.

Niveli i ulët i integritetit dhe mosbesimi ndëretnik brenda komunitetit serb të Kosovës kontribuon në rritjen e këtyre frikave. Edhe pse sulmet terroriste ndaj digave janë të vështira për t'u realizuar, institucionet duhet të adresojnë këto shqetësime duke siguruar monitorim të vazhdueshëm të këtyre infrastrukturave për të zbutur frikën e qytetarëve të shqetësuar.

REKOMANDIME

Ndër rekomandimet kryesore që institucionet e Kosovës duhet të zbatojnë urgjentisht janë:

- > Miratimi i Ligjit të ri për Infrastrukturën Kritike dhe, paralelisht, rishikimi i strategjive kombëtare të sigurisë, konsolidimi i mekanizmave përkatës dhe përditësimi i protokolleve të sigurisë në përputhje me kërcënimet që evoluojnë me shpejtësi.
- > Përafrimi i legjislationit për ujërat me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat (Direktiva 2000/60/EC) për të përmbushur standardet e BE-së. Kjo përfshin zbatimin e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, planeve të pellgjeve lumore, standardeve të cilësisë së ujit, parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e ujërave nëntokësore. Integrimi legjislativ, së bashku me mekanizmat e monitorimit dhe raportimit, do të mbështesë aspiratat e Kosovës për BE dhe do të sigurojë menaxhim të qëndrueshëm të burimeve ujore.

Institucionet e Kosovës duhet gjithashtu të sigurohen që të zbatojnë rekomandimet e mëposhtme:

- > Modernizimi i infrastrukturës së vjetruar, duke përfshirë furnizimin dhe shpërndarjen e ujit, zëvendësimin e tubacioneve të vjetruara, riparimin e rrjedhjeve dhe përmirësimin e impianteve të trajtimit të ujit.
- > Nxitja e partneriteteve me sektorin privat për të sjellë investime, teknologji dhe ekspertizë në projektet infrastrukturore.
- > Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe kontrollit të ndotjes, përmes rregullimit të ndotjes industriale, shkarkimeve bujqësore dhe ujërave të zeza;

vendosja e gjobave për shkelje dhe shpërblimeve për reduktimin e ndotjes.

- > Zgjerimi i trajtimit të ujërave të zeza për të rritur cilësinë e ujit dhe kontrollin e ndotjes.
- > Rritja e gatishmërisë institucionale dhe prezenca fizike veçanërisht në pjesët më jetike të infrastrukturës kritike në gjithë territorin.
- > Forcimi i kuadrit institucional dhe ligjor, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve për MPB, ARRU dhe IHMK përmes trajnimeve dhe zhvillimit.
- > Fillimi urgjent i investimeve, me mbështetjen e BE-së, në liqenin artificial të Firajës, i cili do të ndihmojë ndjeshëm familjet dhe bujqësinë në furnizimin me ujë në pjesët jugore dhe lindore të Kosovës.
- > Reduktimi i humbjeve të ujit, duke përdorur teknologji për zbulimin dhe riparimin e rrjedhjeve, si matës të zgjuar dhe sensorë.
- > Fushata ndërgjegjësuere publike, për të edukuar qytetarët mbi ruajtjen dhe përdorimin efikas të ujit.
- > Planifikimi për reziliencën ndaj ndryshimeve klimatike në infrastrukturën ujore, duke mbrojtur burimet nga ndikimet e klimës dhe duke investuar në rezervuarë dhe menaxhimin e përmbytjeve.
- > Përmirësimi i kontrollit të erozionit dhe përmbytjeve, përmes investimeve strategjike.
- > Investimi në burime të reja të ujit, duke ndërtuar rezervuarë për të dyfishuar kapacitetin e ruajtjes dhe për të siguruar furnizim të qëndrueshëm.
- > Miratimi i parimeve të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (IWRM) për të menaxhuar burimet ujore në mënyrë të qëndrueshme.

REFERENCAT

1. Sulmi në Ibër Lepenc. <https://telegرافي.com/en/The-United-States-condemns-the-attack-on-the-Iber-Lepenci-canal%2C-we-have-offered-our-full-support-to-identify-the-criminals/>
2. Arkiva e The World Factbook. 2021. <https://www.cia.gov/the-world-factbook/about/archives/2021/countries/kosovo/>
3. Banka Botërore në Kosovë. 2023. <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview>
4. Raporti i Vendit për Kosovën. 2024. <https://bti-project.org/en/reports/country-report/RKS>
5. Burimet Natyrore të Kosovës - Ku Ndodhen Burimet Natyrore në Kosovë. 2024. <https://www.earth-site.co.uk/Education/natural-resources-of-kosovo-where-natural-resources-are-located-in-kosovo/>
6. Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës. 2013. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659&langid=2>
7. Direktiva e BE-së 2000/60/EC. 2000. <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2000/60/oj>
8. Ligji Nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike. 2018. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16313>
9. Rishikimi i Parë i Strategjisë Kombëtare të Ujërave të Kosovës 2022-2026. <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/16-24-11-12122022/2-Drafti-per-Rishikimin-e-Strategjise-Shteterore-te-Ujerave-2017-2036-dhe....Anglisht.pdf>
10. Ligji Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe të Tjera. 2011. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2775>
11. Sulmi në Ibër Lepenc. <https://www.kosovopolice.com/en/critical-infrastructure-of-the-iber-lepenci-water-canal-attacked/>

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

621.22(496.51)(047)

Jon Limaj

Ndërtimi i Qëndrueshmërisë së Infrastrukturës Kritike: Pse Institucionet e Kosovës Duhet të Forcojnë Urgjentisht Sigurinë dhe Qëndrueshmërinë e Ujërave të Saj? / Jon Limaj, Mentor Vrajolli. – Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2024. – 11 faqe; 26 cm.

1. Mentor Vrajolli

ISBN 978-9951-842-37-2

RRETH QKSS

E themeluar në prill të vitit 2008, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një organizatë e specializuar dhe e pavarur joqeveritare. Qëllimi primar i QKSS është të promovojë demokratizimin e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe të përmirësojë punën kërkimore dhe avokuese në lidhje me sigurinë, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin e Reformës së Sektorit të Sigurisë duke mbështetur programet e këtij sektori përmes hulumtimeve, eventeve, trajnimeve, avokimit dhe këshillave të drejtpërdrejta për politikë-bërësit.

Avancimi i ideve të reja dhe metodave të shkencave sociale janë gjithashtu vlerat thelbësore të qendrës. Çdo vit, QKSS publikon raporte të shumta, analiza të politikave dhe përmbledhje të politikave për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë. QKSS gjithashtu organizon më shumë se 200 ngjarje publike duke përfshirë konferenca, tryeza dhe debate, ligjërata në Kosovë, ku një pjesë e tyre organizohen në bashkëpunim me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Një gamë e gjerë aktivitetesh përfshijnë hulumtimin, ngritjen e kapaciteteve, ngritjen e ndërgjegjësimit dhe avokimin. Puna e QKSS-së mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë por pa u kufizuar në: reformën dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë, identifikimin dhe analizimin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me ekstremizmin, radikalizmin dhe krimin e organizuar, politikën e jashtme dhe bashkëpunimi rajonal, dhe vlerësimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Këtë vit QKSS shënoi 16 vjetorin e themelimit. Për më tepër detaje rreth QKSS, ju lutem na ndiqni në rrjetet tona sociale:



www.qkss.org

www.securitybarometer.qkss.org



@KCSSQKSS

ISBN 978-9951-842-37-2



9 789951 842372